



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:052869

Datë: 01.03.2019

Numri i dokumentit: 00236266

**P.nr. 289/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren Dega në Suharekë Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me procesmbajtësen Sherife Thaqi sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. E. në adresë fshati L. komuna Suharekë, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II nr. 880-4/17 të dt. 20.04.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur dt. 26.02.2019, në prezencë të Prokurorit të shtetit Atnor Skoro mbrojtësit të akuzuarit av. N. H. nga Suharekë sipas autorizimit, dhe të akuzuarit S. E., mori dhe publikishtë shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari S. E. nga i ati F. dhe e ëma H. e gjinisë V., i lindur me 22.05.1951 në fshatin L. komuna Suharekë, ku edhe tani jeton, me numër personal ....., i martuar, babai i tre fëmijve, penzionist, i gjendjës së dobët ekonomike, me parë i pa dënuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse prej datës së pavërtetuar e deri më 26.12.2016 në fshatin L. komuna Suharekë pikërishtë në shtëpinë e tij përfiton nga shërbimi komunal, përmes rrejetit përçues të rrymës apo rrejetit të shpërndarjes pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njëhsor të cilin në afatin e caktuar nuk e ka dorëzuar, pas dorëzimit është konstatuar se njëhsori për rreth qelqit nga ana e majtë ka të futur shiritin filmik me të cilin është penguar puna e diskut, ashtu që enegjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës KEDS Departamenti Ligjior në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

**-me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së**

Gjykata në kuptim të neneve 7,17,21,41,43,46 49 par. 1 nën parg 1.1, 51, 73,74 320 të KPRK-së, nenit 248 dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit, ia shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË**

Të akuzuarit S. E. ia shqipton dënimin me burg në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim mos të ekzekutohet nese i akuzuari në afatin e verifikimi prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej **150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nese i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, ashtu që një ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) Euro gjobë, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar ne dispozitën e nenit 46 paragrafi 3 te KPK-së.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës dhe atë, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe në emër të taksës për kompensim të viktimave të krimit shumën prej 30 €, të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyruar.

E dëmtuara KEDS –Departamenti Ligjor Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzen PP/II nr. 880-4/17 të dt. 20.04.201, e ka akuzuar S. E. nga fshati L. komuna Suharekë, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 26.02.2019, ka ftuar Prokurorinë e Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ku aktakuzën e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Atnor Skoro dhe të akuzuarin S. E. ashtu siq e parasheh neni 245 parag.1 te KPPRK-së.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siq e parasheh neni 246 parag. 1 i KPPRK-së dhe i akuzuari deklaroi se i ka kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e tij në mbrojtje është respektuar dhe se prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 të ketij kodi ashtu siq e parasheh neni 246 par. 2 i KPK-së.

Ne bazë të nenit 246 par. 3 te KPPRK-së prokurori i shtetit Atnor Skoro ka lexuar aktakuzen PP/II nr. 880-4/17 të dt. 20.04.2017 të Prokurorisë Themelore në Prizren, ku i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe në bazë të nenit 246 parag. 4 të KPPRK-së pasi që gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit i ka ofruar mundësinë të pranohet fajsinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari ka deklaruar se e pranohet fajsinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, ndërsa e mbrojtësi av. N. H. ka theksuar se duke marrë parasysh se i akuzuari ka pranuar fajsinë, ka kuptuar natyrën e aktakuzës, të njëjtën e ka pranuar vullnetarishtë, pa presion, ka qenë bashkëpunues me gjykatën, i njëjti asnjëherë nuk ka qenë i dënuar dhe se është parapagues i

rregullt i enegjisë elektrike, i gjendjës së dobët ekonomike, andaj i propozon gjykatës që kur te shqipton dënim këto ti merr parasysh si rrethana lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues kavlerësuar se i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbështete në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, të gjitha këto të parapara me nenin 248 parag. 1 te KPPRK-së.

Në bazë të nenit 248 par. 2 te KPPRK-së për vlerësimin e pranimit te fajsisë së të akuzuarit, gjyqtari ka kërkuar mendimin e prokurorit të shtetit dhe i njejtë deklaroi se janë plotësuar kushtet nga neni 248 parag. 1 të KPPRK-së.

Ne bazë të nenit 248 parag. 4 te KPPRK-se, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i ketij neni mori aktvendim me të cilin e pranoi pranimin e fajsisë nga i akuzuari dhe vazhdoi me shqyrtimin për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit e Prokurorisë Themelore Prizren Atnor Skoro lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzes, pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit është e mbeshtetur në provat materiale, prova këto nga të cilat është ngritur aktakuza, andaj vlerësoj se ky pranim i fajsisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni dhe mbeshtetur në keto prova dhe në pajtim me vullnetin e të akuzuarit, i sic rezulton nga të gjitha faktet e paraqitura si në aktakuzë.

I pandehuri S. E. deklaroi se pranoj fajsinë, për këtë ndihem i penduar, i premtoj gjykatës se nuk do të përsërisë veprën e tillë, më parë asnjëherë nuk kam qenë i dënuar, jam babai i tre fëmijëve, i gjendjës së dobët ekonomike, këto rrethana gjykata ti ketë parasysh dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptohet një dënim më i butë.

Duke i vlersuar me ndërgegjeje provat e nxjerrura në procedurë një nga një dhe në lidhje me provat tjera në bazë te nenit 7 parag.1 dhe nenit 361 te KPP-se gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e deri më 26.12.2016 në fshatin L. komuna Suharekë pikërishtë në shtëpinë e tij përfiton nga shërbimi komunal, përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar energjinë elektrike me njësor të cilin në afatin e caktuar nuk e ka dorëzuar, pas dorëzimit është konstatuar se njëhori për rreth qelqit nga ana e majtë ka të futur shiritin filmik me të cilin është penguar puna e diskut, ashtu qëenëgjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës KEDS Departamenti Ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit si dhe nga provat dhe faktet qe i përmban aktakuza, kallzimi penal i KEDS-Departamenti ligjor ne Prizren me nr. CMS-K/5... të dt 20.03.2017, procesverbali i kontrollimit detal të njëhisorit të energjisë elektrike të Distriktit Prizren numer 3... dt.27.02.2017, faktura e llogaritjes – rikthimit të humbjeve DPZ-17HP..... të dt.19.01.2017 fatura me nr. 15.... te dt.03.02.2017 si dhe fotodokumentacioni në shkresat e lëndës.

Nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë nga veprimet e të akuzuarit S. E. përmbushën të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, të cilën e ka kryer me dashje direkte, duke përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe pa autorizim shfrytëzimin e energjisë elektrike pa u regjistruar duke dëmtuarin diskun me shirit filmik.

I akuzuari e ka kryer veprën penale sepse në bazë të nenit 7 të KPRK-së, kjo vepër penale është e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e se cilës janë të përcaktuar me ligj dhe për të cilën është përcaktuar sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Për këtë vepër penale i akuzuari është shpallur fajtor sepse ne përputhje me nenin 17 parag.1 të KPK-së, kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nese është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.

Ne rastin konkret i pandehuri këtë veper e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 parag. 1 dhe 2 të KPRK-së, ku dhe i është shqiptuar sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 73,74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin muar faktin se e ka pranuar fajsinë, se ndihet i penduar, më parë nuk ka qenë i dënuar, është babai i tre fëmijëve, ka qenë bashkëpunues me gjykatën, i gjendjes së varfër ekonomike, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti.

Për këtë vepër penale është paraparë denimi me gjobë dhe burg prej deri në 3 vite, të njejtit iu shqiptua dënimi me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve me kusht duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcnim të dënimit me burg është e nevojshëm që të ndaloj kryersin të mos kryej vepra tjera penale sipas nenit 50 të KPRK-së, nese i akuzuari në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro), me bindjen se këto dënime janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi ne nenin 450 parag. 3 të KPPK-së ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen financiare të akuzuarit, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimit bazuar ne nenin 39 parag. 3 të ligjit mbi kompensimin e viktimave të krimit nr. 05/L-036.

Vendimin që të dëmtuarës lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale të udhëzoj në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 parag. 2 të KPPRK-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:052869, 26.02.2019**

**G j y q t a r i**

---

Lavdim Bajraktari

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:052869  
Datë: 01.03.2019  
Numri i dokumentit: 00236266